

**VENDIM**  
**Nr. 104, datë 13.2.2013**

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NGA BUXHETI I VITIT 2013, PËR  
BASHKËSITË FETARE TRADICIONALE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME  
KËSHILLIN E MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 6 të ligjit nr. 10 140, datë 15.5.2009 “Për financimin nga Buxheti i Shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave”, të nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Masa e financimit, prej 105 162 000 (njëqind e pesë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekësh, nga buxheti i vitit 2013, i miratuar për të mbështetur bashkësitë fetare, të përdoret sipas ndarjes së mëposhtme:
  - a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 30 492 000 (tridhjetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:
    - i) 11 340 000 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e dyzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 90 punonjës të administratës;
    - ii) 19 152 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 152 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.
  - b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 24 948 000 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:
    - i) 19 908 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 158 punonjës të administratës;
    - ii) 5 040 000 (pesë milionë e dyzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.
  - c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 24 948 000 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:
    - i) 5 670 000 (pesë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 45 punonjës të administratës;
    - ii) 19 278 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 153 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.
  - ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 24 774 000 (njëzet e katër milionë e shtatëqind e katër mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:
    - i) 3 528 000 (tre milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 28 punonjës të administratës;
    - ii) 14 246 000 (katërmëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë, për ndërtimin e Selisë së Shenjtë të Kryegjyshit Botërore Bektashiane (Odeonit);
    - iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë si Kryegjyshit Botërore, me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj, në kërkesën e vitit 2013, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur për kryerjen e veprimtarive të parashtruara.

2. Kalimi i fondit të bëhet brenda tremujorit të parë të vitit 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**